



Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkëlqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL	Datë: 19/07 /2018 Nr. 020-771
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës se Glllogocit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 462-37732/18 për shfuqizimin e vendimit nr.421-281 të datës 18.01.2018 me të cilin është dhënë në shfrytëzim ngastra kadastrale nr.760/2 dhe 761/1 qendrës së komunitetit në Glllogoc me sipërfaqe 55.40m ² evidentuar pronë komunale e kuvendit komunal të komunës së Glllogocit
I miratuar më datë: 27.06.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.07.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik opštine Glogovac Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a
Od:	Shkelqim Jakupi, rukovodilac pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Glogovac
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.462-37732/18 za poništenje odluke br.421-281 dana 18.01.2018. godine, putem koje je dato na korišćenje katastarska parcela br.760/2 i 761/1 zajedničkog centra u Glogovcu, u površini od 55.40m ² , utvrđena kao opštinska imovina Skupštine opštine Glogovac.
Usvojena dana: 27.06.2018. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 04.07.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 462-37732 dt. 03.07 2018



(8)0009

Duke u bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2, nenit 40 paragrafi 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5 shkronja h, nenit 34 pika 34.6 si dhe nenit 86 shkronja a të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt.27.06.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit NR. 421/281 të datës 18.01.2008, në të cilën është dhënë objekti i Qendrës së Komunitetit në Glllogoc në shfrytëzim Qendres Dielli

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet kthimi i Objektit Qendra e Komunitetit në Glllogoc, ngastrën kadastrale 760/2 dhe 761/1 me sipërfaqe prej 55.40 m2 në Glllogoc të dhënë mbi bartjen administrative të së drejtës shfrytëzimit të Qendrës së Komunitetit në Glllogoc.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi nr.421-281 i datës 18.01.2008, i Kuvendit Komunal mbi bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të Qendrës së Komunitetit në Glllogoc, me bazë të cilit është lidhur marrëveshja ndërmjet Caritas Zvicër dhe Komunës së Drenasit për periudhën nëntor 2014 deri në dhjetor 2017 më të cilën vendim është dhënë Objekti i Qendrës së Komunitetit në Glllogoc në shfrytëzim Objekti Qendra Dielli në Glllogoc, ngastrën kadastrale nr.760/2 dhe 761/1 me sipërfaqe prej 55.40 m2 në Glllogoc.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Caritasi Zvicran me përfaqësues Kreshnik Berisha nga Prizreni dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt.05.02.2018, Nr. 09-610-7412



PËR: Caritasit Zviceran

NGA: Tafil Halilaj – Drejtor për Arsim në Drenas

LËNDA: Njoftim

Drejtori i Drejtoratit për Arsim në Drenas e e njofton Caritas Zviceran se përgjegjësitë dhe detyrimet në mes Komunës së Drenasit dhe Caritas Zviceran janë përbushur për periudhën Nëntor 2014 deri 31 dhjetor 2017, si: sipas marrëveshjes së nënshkruar nga Komuna Drenasit dhe Caritasin Zvicerran për shfrytëzimin e dy dhomave (një zyre dhe një dhomë trajnimit) dhe nga buxheti komunal janë mbuluar të gjitha shërbimet dhe të kostove të financimit për qëndren Dielli (operimit dhe mirëmbajtjes, ngrohjes, energjisë elektrike, komunikimit dhe internetit, etj.) dhe borxhi i mbetur në shumën prej 16,000 Euro që Komuna/DKA i ka pasur detyrim Caritasit Zviceran është kompenzuar nga Komuna Drenas/DKA për shfrytëzimin e dy dhomave, shpenzimeve tjera të lartcekura prej periudhës Nëntor 2014 deri në Dhjetor 2017, prandaj Komuna Drenas/DKA e njofton Caritasin Zviceran se nuk i ka borxh asnjë euro dhe ato dy dhoma (Zyra dhe dhoma e trajnimit) dhe prej datës 01.01.2018 ka përfunduar marrëveshja në mes Komunës së Drenasit dhe Caritasin Zviceran.

Ju faliminderit për mirëkuptim!

Drenas,
Më: 05.02.2018



Drejtori për Arsim
Tafil Halilaj

Përmbajtja e Vërtetimit / Faturës nga Komuna e Drenasit

Marrëveshja bazë: "Dorëzimi i objektit dhe vazhdimin e punës në qendër Dielli për periudhën Nëntor 2014 deri në Dhjetor 2017"

Periudha: Nëntor 2014 – Dhjetor 2017 (38 muaj)

Vlera = 16'000 EUR

Për: Sipas marrëveshjes së nënshkruar me Caritasin Zviceran për shfrytëzimin e dy dhomave (një zyre dhe një dhomë trajnimi) dhe mbulimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes (energji elektrike, uji, ngrohja, komunikimi dhe internet)

Vërejtje:

Me këtë dokument të lëshuar nga komuna e Drenasit, Caritasi Zviceran nuk obligohet për pagesë pasi që ajo ka dhënë në shfrytëzim dy dhoma në qendrën Dielli në Drenas. Respektivisht edhe mbulimin e shpenzimeve të ndërlidhura të mirëmbajtjes. Ajo shumë do të shlyhet nga borxhi i mbetur në shumë prej 16'000 EUR që Komuna / DKA e Drenasit i detyrohet Caritasit Zviceran që nga viti 2011.



C-C-Q



MARRËVESHJE

ndërmjet

HPF Multiversity - Universiteti Ndërkombëtar i Kompetencave /
Katedër e kompetencave dhe kualifikimeve C-C-Q
në bashkëpunim me donatorët nga rrjeti CCQ ndërkombëtar,
Weissensteintasse 81, CH-4501 Solothurn, Zvicër

dhe

Komuna Drenas (Glogovac), Drejtoria Komunale e Arsimit, Kosovë

që bëjnë me

**Pilot Projekti Hulumtimi për Edukimin Parashkollor dhe projektet e
Hulumtuese plotësuese për edukimin mësimorshëm dhe të lartë në Komunën e
Drenasit**

për periudhën Shtator 2013 deri në Gusht 2014

Bazuar në rezultatet pozitive të Programit Parashkollor Bachelor dhe instalimin e disa qendrave të edukimit parashkollor në komunën e Drenasit nga viti 2002 deri me tani, ne duam të promovojmë edukimin parashkollor në Drenasë konform standardeve bashkëkohore arsimore. Drejtoria Komunale e Arsimit në Drenas dhe HPF Multiversity si dhe CCQ bien dakord për të filluar një bashkëpunim të përbashkët dhe të bashkëpunojmë.

Të gjithë partnerët janë të përkushtuar të realizojnë objektivat e mëposhtme të projektit.

Objektivat e projektit

Zbatimi i një inspeksioni për monitorim dhe vlerësim të nivelit të funksionimit të mësimorshëm dhe të lartë në veçanti në fushën e edukimit parashkollor dhe disiplina plotësuese të tilla si: psikologji, menaxhim i shkollës, udhëheqje biznesi, etj.

A. M.

1

Përgjegjësitë dhe detyrimet

a) Drejtoria Komunale Arsimit (DKA) në Drenas pajtohet që:

- Të sigurojë mjediset dhe mblëmbajtjen (përfshirë, qiranë, ujë, energjinë elektrike, ngrohjen, pastrimin dhe sigurinë) për zbatimin e mësimdhënies dhe hulumtimit në fushën e edukimit të mëtejshëm dhe të lartë në objektin Drenas III.
- Kontratat me 16 mësimdhënese të trajnuara nga IPF, do të nënshkruhen deri në fund të muajit Gusht 2013, për një vit shkollor.

b) IPF Multiversity dhe C-C-Q pajtohet që:

- Të kontribuojë me një shumë prej 58'076.16 euro. (në fund të çdo muaji me 4'839.68 euro, me transferim të parë në fund të muajit Shtator 2013) për shpenzimet e pagave për 16 edukatore, për një vit, nga pilot projekti Edukimi Parashkollor i Caritas.
- Të konfirmojë me universitetet partnere të akredituara që këto edukatore të cilët kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit të tyre Bachelor nën IPF për Edukimin Parashkollor, diplomat janë duke u vërtetuar dhe njohur në Kosovë në nivel Bachelor deri në fund të muajit Maj 2014.
- IPF do të shkruaj një libër (ose disa) dhe prodhimin e një video dokumentar (ose disa) në lidhje me projektin hulumtues/kërkimor të kësaj Marrëveshje.
- Edukatori, prindërit dhe fëmijët e këtyre klasave/grupeve parashkollorë të pilot hulumtimit do të informohen në fillim të vitit shkollor në lidhje me këtë hulumtim dhe duhet të japin lejen për të drejtat e autorit dhe kopjimin e materialit para fillimit të vitit shkollor.
- Të ardhurat (financat) e mëtejshme dhe rezultatet nga mbledhja e fondeve, pagesat nga donatorët dhe fondet të tjera kërkimore, të ardhurat nga shitja e librave dhe DVD-ve ose shitjeve të tjera kërkimore dhe të ardhurave janë kompensimin i pagesës nga IPF dhe do të jenë paguar në logarinë e IPF.
- IPF do të ketë pronësinë e këtyre të ardhurave.

Agjenda e Projektit

- Brenda 3 muajve të parë (më së voni deri në tetor 2013), bazuar në këtë Marrëveshje partnerët do të përcaktojnë hapat e ardhshëm dhe përgjegjësitë.
- Brenda kësaj kohe do të themelohet Bordi i Cilësisë
- Anëtarët e Bordit të Cilësisë që janë kërkuar, propozohen nga partnerët: DKA Drenas, IPF dhe C-C-Q.

Kushtet

Edukatorët parashkollor (16) të lartë përmendura në Drenas, të cilët kanë përfunduar me sukses studimin e tyre në pilot programin parashkollor nga IPF të kenë një punë të rregullt me një kontratë një vjeçare në klasat parashkollorë në Komunën e Drenasit, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje. Pagesat mujore për edukatorët nga IPF do të paguhen vetëm nëse 16 edukatorët do të kenë të siguruar dhe konfirmuar vendin e tyre të punës.

A. M.

+

Dispozitat përfundimtare

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitës së kësaj Marrëveshje do të zgjidhet përmes negociatave të drejtpërdrejta.

Në rast të mos-përputhjes, mosëkzekutimit apo thyerjen e njëres nga palët të detyrimeve të cekura, pala tjetër mund, pas njollimit me shkrim, të përfundojë marrëveshjen duke respektuar një vonesë prej tre muajsh.

Në rast të paparashikuar ose i "forcës mëdhorë" rrethana të cilat mund të pengojnë zbatimin e projektit, palët kontraktuese mund të shtyjë ose të përfundojë marrëveshjen menjëherë pas konsultimeve. Në rast të tillë ata do të takohen për të rënë dakord mbi modalitetet e mëtejme në mënyrë që të sigurohet se ndërprerja e parakohshme e projektit nuk ka pasoja të mëdha për popullatën në fjalë.

Çdo amendament i kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të dy palëve.

Marrëveshja e pranishme, e cila e mbulon periudhën nga Shtatori 2013 deri në Gusht të vitit 2014 do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të ndërsjellë nga të dy palët kontraktuese dhe do të mbetet në fuqi derisa palët kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre.

Firmosur në dy (2) kopje identike në anglisht dhe në dy (2) kopje identike në shqip

Bruksel/Soloturn



26.06.13

Drenas

26.06.2013

Për: PF MultiVersity dhe C-C-Q

Për: Drejtorin Komunal të Arsimit, Drenas



[Signature]
Z. Arsim Mehmeti
Drejtor i DKA Drenas



MARRËVESHJE

ndërmjet

Caritas Zvicër

Löwenstrasse 3, CH-6002 Lucerne, Switzerland

Në bashkëpunim me Caritas Kosova dhe
në emër të Qeverisë së Lihtenshtajnit dhe fondacionit Medicor

dhe

Komuna/DKA Drenas, Kosovë

në lidhje me

**Dorëzimi i objektit dhe vazhdimin e punës në qendër Dielli
për periudhën nëntor 2014 deri në dhjetor 2017**

Në mënyrë që të promovojë arsimimin profesional pedagogjik para-shkollor në Kosovë konform standardeve bashkëkohore pedagogjike, për të lehtësuar integrimin e fëmijëve në sistemin e zakonshëm të shkollës fillore, Komuna e Drenasit dhe Caritas-i i Zvicrës bien dakord për të vazhduar bashkëpunimin e tyre.

1. Objektivat

1.1 Objektivat e përgjithshme

Të kontribuojë në integrimin social të fëmijëve, si dhe në qendrat pedagogjike parashkollore moderne në Kosovë, duke marrë parasysh situatën e veçantë të pasluftës dhe transformimin e shoqërisë në Kosovë.

1.2 Objektivat specifike

- Për dorëzimin e objektit të qendrës Dielli Drejtorisë Komunale të Arsimit; Për të siguruar menaxhimin e orientuar cilësor dhe të qëndrueshëm të qendrës Dielli dhe siguruar konceptin afatgjatë të shfrytëzimit dhe strukturës mbikëqyrëse;
- Konsolidimi / sigurimi i qëndrueshmërisë institucionale për 5 klasa aktuale parashkollore dhe 1 dhomë të mësuesve të përfshirë në qendrën Dielli, nëpërmjet monitorimit profesional dhe të rregullt të klaseve parashkollore dhe 8 grupeve të fëmijëve.

- c) Për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të edukatoreve; dhe të ofrojë për të gjithë edukatorët e edukimit parashkollor praktika adekuat edhe trajnime sipas standardeve të reja.
- d) Për të vlerësuar rregullisht performancën e edukimit parashkollor, si dhe integrimi i fëmijëve në shkollat fillore, duke kontribuar me përvojat e një strategjie kombëtare parashkollore dhe trajnimet e mësimdhënësve.

2. Përgjegjësitë dhe detyrimet

a) Komuna pajtohet

- Për të marrë përsipër nga Caritasi i Zvicrës objektin e Qendrës Dielli dhe pajisjet, nën administrimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e tyre duke përdorur konceptin e strukturuar të menaxhimit afatgjatë.
- Që të japë në përdorim Caritasit të Zvicrës dhomat si mëposhtë:
në katin e dytë [një (1) zyrë (25 m²) dhe një (1) dhomë të trajnimit për mësuesit (65 m²)] për periudhën nëntor 2014 deri më 31 dhjetor 2017; dhe garanton funksionimin korrekt dhe mirëmbajtjen e qendrës Dielli në teresi në bashkëpunim me menaxhmentin e shkollës.
- Të sigurojë nga buxheti komunal mbulimin e të gjitha shërbimeve dhe të kostove të financimit për qendrën Dielli (operimit dhe mirëmbajtjes, ngrohjes, energjis elektrike, komunikimit dhe internetit, etj)
- Që nëpërmjet të dhenjes me qira të këtyre dy dhomave dhe mbulimin e shpenzimeve të përmendura më lartë do të zbritet borxhi i mbetur në shumën prej 16,000 Euro që Komuna/DKA i detyrohet Caritasit Zviceran, dhe kete për periudhën deri në dhjetor 2017.
- Për të siguruar bashkëpunimin e nevojshëm me Caritasin e Zvicrës dhe të sigurojë mbështetje në lidhje me bashkëpunimin.

b) Caritas-i Zviceran pajtohet

- Të promovojë shkëmbimin e përvojave, rrjetizimin dhe avokimin në mes koordinatorit pedagogjik dhe ekipin e projektit të Caritasit Zviceran dhe aktorë të tjerë në këtë fushë në Kosovë.

4. Kushtet

Klasat parashkollore në qendrën Dielli janë sipas standardeve të MASHT-it. Klasat dhe edukatorët do të mbikëqyren nga koordinatori pedagogjik në bashkëpunim me DKA Drenas.

Klasat parashkollore në qendrën Dielli, duke përfshirë klasat parashkollore në fshatra të ndryshme nga projekti Edukimi Parashkollor i Caritasit Zviceran, duhet të jenë plotësisht të integruara në sistemin arsimor vendor.

5. Dispozitat përfundimtare

Çdo mosmarrëveshje midis Palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e dispozitës së kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet përmes negociatave të drejtpërdrejta.

Si një organizatë humanitare e cila financon kontributet e saj përmes donacioneve dhe pjesëmarrjen e palëve të treta (Qeveria e Lihtenshtajnit, donacionet private), Caritas-i i Zvicrës mund të angazhohet vetëm brenda kufijve të të ardhurave të saj.

Në rast të mos-përputhjes, mosekzekutimin apo thyerjen e detyrimeve të njëres nga palët, të detyrueshme mbi të, pala tjetër mund, pas njoftimit me shkrim, të përfundojë marrëveshjen e respektuar me një vonesë prej tre muajsh.

Në rast të paparashikuar ose i "forcës madhore" rrethanave të cilat mund të pengojnë zbatimin e projektit, Palët kontraktuese mund të shtyjë ose të ndërpresin Marrëveshjen menjëherë pas konsultimeve. Në këtë rast ata do të takohen për të rënë dakord mbi modalitetet e mëtejshme, në mënyrë që të sigurohet se ndërprerja e parakohshme e programit nuk ka pasoja të mëdha për popullsinë në fjalë.

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të dy palëve.

Marrëveshjeje, e cila mbulon periudhën nga nëntor 2014 deri në dhjetor 2017, do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të ndërsjellë nga të gjitha Palët kontraktuese dhe do të mbejti në fuqi deri sa palët kanë përmbushur të gjitha detyrimet e tyre.

Nënshkruar me në dy (2) kopje identike (në Anglisht dhe Shqip).

Prizren/Drenas

Për Caritas Zvicër

Zt. Kresnik Basha
Shef i Zyrës

Zt. Albert Bakalli
Përgjegjës i projektit

Për Komunën

Zt. Nexhat Demaku
Kryetar i Komitës

Zt. Sadik Tahiri
Drejtor i DKA Drenas



Republika e Kosovës
Republica Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSNOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315016-00760-2

Numri i lendes / Broj Predmet / Case Referent Number:	12-463-37732
Data dhe koha e fshimit / Datum i vrecne izdavanja / Date and time of submission:	09.07.2018 - 10:59
Komuna / Opština / Municipality:	Gllgovac / Gllgovac / Gllgovac
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Gllgovac / Gllgovac / Gllgovac

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar me datën Izrađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315016-00760-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	3063			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar me datën Izrađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ASHANOJK/A-SHANJOKE/ASHANOJKA ASHANOJKE/ASHANOJKA-ASHANOJKE		ASHANOJKA-SEANOJKE		



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Superfaqja povrsina Area (m ²) (m ²)
1	Tokë Ndërtimore/Grafiq, evensko zemljište (Constructio) land	Oborrt/Donor site/Back yard		3063

B. PRONARI/POSEDESI - VLASNIK/DRZALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lleni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postai Postanski kod Postal code	Hollësi të e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / single possessor	Pron Komunalë KK Gllugoc shfrytëzues Qendra e Komunitetit Gllugoc	KCID9141.2688	Gllugoc / Gllugovac / Gllugoc /			1/1		



Driton Xhafa

From: Shkrimorja Mapl
Sent: Thursday, July 12, 2018 8:13 AM
To: Driton Xhafa
Subject: FW: Informata shitesë
Attachments: Materiali Shtese.pdf

From: Labinot Halilaj
Sent: Wednesday, July 11, 2018 3:11 PM
To: Shkrimorja Mapl <Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net>; Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
Cc: Shkelqim Jakupi <Shkelqim.Jakupi@rks-gov.net>; Ramiz Lladrovci <Ramiz.Lladrovci@rks-gov.net>
Subject: Informata shitesë

Të nderuar,

Po ju shkruaj në lidhje me vendimet e Kuvendit të Komunës së Drenasit të cilat janë aprovuar mbledhjen e mbajtur me datën 27.06.2018, rrespektivisht vendimet nr.353/37736 dhe nr.462/37732, per te cilat me daten 06.07.2018 keni kerkuar informata shitesë

Bashkangjitur keni Certifikatat e Pronesise të kerkuara për Vendimet nr.353/37736 dhe nr.462/37732, si dhe

Marreveshjet e lidhura ne mes të Komunës së Drenasit dhe Caritas Zviceran, ku me daten 05.02.2018 eshte njoftuar Caritasi Zviceran nga Komuna e Drenasit, respektivisht Drejtoria per Arsim per perfundimin e marreveshjes ne mes tyre.

Pra me rastin e vendimit Nr.462/37732 per shfuqizimin e vendimit Nr.421/281 të dates 18.01.2008, ne të cilin eshte dhene objekti i Qendres së komunitetit në Glllogoc ne shfrytezim Qendres Dielli, nuk ka pasur Raport të komisionit per nderprejrze te kontret sepse ka perfunduar marreveshja e lidhur ne mes të Komunes së Drenasit dhe Caritasit Zviceran.

Ju lutemi që te konfirmoni pranimin e emailit.

Me respekt,
Labinot Halilaj
Kryesues i Kuvendit Komunal
Komuna e Drenasit
Tel; 03820040872
Mob; +38349708000
Emali; labinot.halilaj@rks-gov.net